



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1084 Prot.

Tiranë, më datë 01.12.2023

VENDIM

Nr. 583, datë 01.12.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.12.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në Parkun Arkeologjik të Durrësit”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "A", me vendndodhje Bashkia Durrës, me zhvillues **Bashkia Durrës**.
2. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike, hartuar nga subjekti i licensuar Z. Luan Përzhita;
3. Zhvilluesi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licensuar në arkeologji, për kryerjen e sondazheve arkeologjike;
4. Rezultatet e sondazheve arkeologjike, do të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në mbledhjen e KKTKM-së;
5. Punimet për infrastrukturën nëntokësore, të parashikuar në projekt, duhet të shoqërohen më një program monitorimi arkeologjik dhe dokumentimit të depozitohen pranë IKTK;
6. Gjatë procesit të zbatimit, sic parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbykëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
8. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
9. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

